

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 314, Datë 12.12.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 154, DATË
31.07.2024 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE ERZEN” SH.P.K., NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC
“HEKALI”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2855/2 prot., datë 25.11.2025, “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024 “Mbi licencimin e shoqërisë “AGE ERZEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “HEKALI”,

Konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 154, datë 31.07.2024, ka licencuar shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”.
- Në pikën 2 të vendimit nr. 154/2024 është përcaktuar se shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 18.09.2025.
- Në pikën 4 të vendimit nr. 154/2024 i është kërkuar shoqërisë që brenda datës 30.10.2024 të depozitojë dakordësinë e kontraktorit të punimeve mbi financimin dhe certifikimin e shpenzimeve për ndërtimin e veprës.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i administruar

- ERE, me shkresën nr. 2855 prot., datë 13.11.2025, i ka kërkuar shoqërisë paraqitjen e dokumentacionit për rinovimin e lejes së përdorimit të burimit ujor, pasi vlefshmëria e lejes së mëparshme ka përfunduar më 18.09.2025.
- Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k., me shkresën nr. 66 prot., datë 18.11.2025, protokolluar në ERE me nr. 2855/1 prot., ka paraqitur Vendimin nr. 16, datë 23.12.2024 të KBU Erzen për miratimin e rinovimit të lejes, si dhe Lejen e re nr. 18/12, datë 08.01.2025, e vlefshme deri më 08.01.2030.
- Sa i përket pikës 4 të vendimit nr. 154/2024, shoqëria, me shkresën nr. 91 prot., datë 29.10.2024, protokolluar në ERE me nr. 2180/1 prot., ka depozituar deklaratën e kontraktorit, duke përmbushur detyrimin e vendosur

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se leja e re e përdorimit të burimit ujor është lëshuar më 08.01.2025, pra brenda afatit të vlefshmërisë së lejes së mëparshme, megjithëse depozitimi në ERE është kryer me vonesë.
- Leja e re ka një periudhë vlefshmërie 5-vjeçare, deri më 08.01.2030, çka krijon nevojën që pika 2 e vendimit të licencimit të ndryshohet për të reflektuar afatin e ri.
- Shoqëria ka përmbushur plotësisht kushtin e përcaktuar në pikën 4 të vendimit, duke depozituar deklaratën e kontraktorit në datën e kërkuar.
- Si rrjedhojë, pika 4 duhet të shfuqizohet, pasi elementi kushtëzues është realizuar.
- Pika 3 e vendimit vijon të mbetet e zbatueshme për sa i përket efektit juridik të mosdepozitimit të lejes, por do të interpretohet në funksion të afatit të ri 08.01.2030.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në mbështetje të nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë, vlerësohet se:
- Pika 2 e vendimit nr. 154/2024 duhet të ndryshohet për të reflektuar afatin e ri të vlefshmërisë së lejes së përdorimit të burimit ujor, si në vijim: *“Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 08.01.2030”*.
- Pika 4 e vendimit nr. 154/2024 duhet të shfuqizohet pasi shoqëria e ka përmbushur kushtin e vendosur.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pika 2 e vendimit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, ndryshohet si vijon: *“Shoqëria “AGE ERZEN” sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 08.01.2030.”*
2. Pika 4 e vendimit të ERE-s nr. 154, datë 31.07.2024, shfuqizohet.
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme të njoftojë shoqërinë “AGE ERZEN” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, “OSSH” sh.a. dhe “FTL” sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI